



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Dokumentit me nr. 6694/1 prot., datë 29.12.2023, “Manuali i Burimeve Njerëzore të OST sh.a.”, si dhe Dokumentit me nr. 3329/2 prot., datë 28.05.2021, “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Njësitë Operative dhe Njësinë e Mirëmbajtje Transmetimit” (e rishikuar), OST sh.a. shpall procedurën e rekrutimit për pozicionin e mëposhtëm:

Remontier, Sektori i Mirëmbajtjes së Linjave, Njësia Operative Tiranë (NJOT)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ka për detyrë të bëjë kontrole periodike 2 herë në muaj në linjat që mbulon.
- Në bashkëpunim me përgjegjësën e ekipit harton programin e kontrollit në linja.
- Plotëson formularët e kontrollit sipas tabelave të miratuara në DSHMT.
- Raporton çdo ditë punet që do kryej dhe që ka realizuar.
- Raporton dy herë në muaj pranë sektorit për kontrollet e kryera, problematikën e hasur si dhe masat e marra.
- Kryen kontrole jashtë radhe, pas diteve me stuhi, ngrice vershimeve të lumenjve si dhe për çdo çkycje nga mbrojtja rele për lidhje të shkurtra. Për rastin e fundit, kontrolli duhet të fillojë jo më vonë se 16 orë nga çkycja e linjës.
- Kryen punime të nevojshme në linja që kryhen pa heqjen e tens si: pastrime arseje, pastrime bazamente, matje tokëzimeve plotësim me tabela të sigurimit teknik etj.
- Identifikon në një regjistër të veçantë ndërtimet pranë linjave.
- Merr pjesë në remontet e planifikuara të linjave që mbulon në bashkëpunim me pjesën tjetër të Sektorit.
- Kryen detyra të veçanta të ngarkuara nga sektori sipas problematikës që lind.

Kërkesat e përgjithshme, që duhet të plotësojë kandidati për punësim:

- Të ketë shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara;
- Të jetë i aftë për punë;
- Të mos jetë i dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë;



- Të gëzojë integritet moral dhe profesional, si dhe të mos jetë marrë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës;
- Të mos ketë lidhje familjare me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkie;
- Personat që kandidojnë për këtë pozicion, duhet të kenë të paktën 2 -vite eksperiencë pune në fusha relevante.

ARSIMI I KËRKUAR:

I mesëm elektrik/I mesëm me kualifikim të lartë elektrik/mekanik/e mesme e përgjithshme me kualifikim elektrik

Dokumentat për dorëzim

Faza e Vlerësimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Arkivë-Protokollit, në Aparatin Qendror të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose nëpërmjet postës elektronike: info@ost.al, këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (CV)
2. Dëftesë e arsimit të mesëm/ Çertifikata të kualifikimeve profesionale
3. Çertifikime të tjera relevante

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të bëhet brenda datës 31.03.2024.

Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.



Dokumentat për dorëzim

Faza e lidhjes së kontratës:

1. Librezën e punës (nëse ka) ose vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore.
2. Fotokopje e noterizuar diplomës sëbashku me listen e notave
3. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
4. Fotokopje ID
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga gjykata.
7. Vërtetim nga prokuroria.
8. Çertifikatë familjare
9. Dëshmi të ndryshme kualifikimi.